

#21



SHTATOR
2022



Advocacy Center
for Democratic Culture

BULETINI



office@acdc-kosovo.org
ngoacdc@gmail.com



Cika Jovina 3, North Mitrovica
Prote Mateje 48, Belgrade
Fehmi Agani 168/5, Prishtina



AKSIONI RRUGËS NË PRISHTINË

for Democratic Culture

Në kuadër të projektit “Iniciativa për Edukim kundër Dhunës në Familje dhe Seksuale”, Qendrës për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal CLARD, në bashkëpunim me OJQ ACDC - Qendrën Avokuese për Kulturë Demokratike dhe Institutin e Kosovës për Drejtësi, organizuan një aksion rrugor në Prishtinë me qëllim ngritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për problemet e dhunës me bazë gjinore dhe në familje, si dhe të ofrojë informata të nevojshëm për përdorimin e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës. Në këtë aktivitet morën pjesë qytetarët, mediat dhe përfaqësues të Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).



@ clardkosovo | Facebook



Ky aktivitet shënoi përfundimin e projektit dhe paraprirë nga një sërë nismash në të gjitha komunat e Kosovës që për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë e parandalimit dhe veprimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore me synim të përgjithshëm mbrojtjen e grave si grupi më i cenueshëm.

CEREMONIA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS

@ KCSF | Facebook

Më 15 shtator, në ambientet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) u mbajt ceremonia e nënshkrimit të kontratës me përfituesit e granteve në kuadër të programit 'EJA Kosovë'. Marrëveshjet e grantit janë nënshkruar me pesëmbëdhjetë organizata nga e gjithë Kosova, duke përfshirë OJQ ACDC, e cila ishte në mesin e tetë organizatave përfituese të grantit për zhvillim organizativ.



Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të ngisë kapacitetet e stafit të organizatës në mënyrë që të krijojë një drejtim të qartë të zhvillimit organizativ duke përdorur mjete dhe burime specifike që do të kontribuojnë në rritjen e organizatës.

KURSI I GJUHES SHQIPE



Në kuadër të grantit të zhvillimit organizativ, do të ofrohet një program 12-mujor i kursit të gjuhës shqipe për të pajisur ekipin e ACDC me aftësi gjuhësore që do të jenë të një rëndësie të madhe për aktivitetet e ardhshme. Në shtator, ACDC angazhoi një bashkëpunëtor të jashtëm i cili do të zhvillojë mësimet të gjuhës shqipe për stafin e ACDC për 12 muajt e ardhshëm.

Ky grant mbështetet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', i bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Suedi, dhe Qeveria e Dukës të Madh të Luksemburgut.

VIZITË E STUDENTËVE NGA EMA

Gjatë vizitës studimore në Kosovë, një grup studentësh ndërkombëtarë të Programit Master Evropian në të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim (EMA) vizituan zyrën e OJQ ACDC në Mitrovicën e Veriut, ku u prezantuan studentëve punën e organizatës dhe i'u përgjigjën pyetjeve të tyre gjatë diskutimit.



Studentët shprehën interesim të madh për situatën e përgjithshme në Kosovë, integrimin e gjyqësorit në sistemin juridik të Kosovës, si dhe zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit.



KONFERENCA E GJYQËSORIT



Më 29 shtator, OJQ ACDC organizoi konferencën që u fokusua në funksionimin e gjyqësorit të integruar në zonat serbe të Kosovës. Panelistë ishin Jovana Fillipoviç, juriste nga Graçanica, Stefan Millentijeviç, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe Doruntina Mehmeti, hulumtuuese në Institutin e Kosovës për Drejtësi. Konferenca shërbeu si ngjarje përfundimtare e projektit të titulluar "Rritja e Transparencës dhe Sundimit të Ligjit në Kosovë – Komunitetet me Shumicë Serbe".



TAKIMI I RRJETIT TË GRAVE

Në shtator, takimet me anëtarët e rrjetit të sapokrijuar të grave nga veriu i Kosovës vazhduan për të planifikuar aktivitetet e ardhshme dhe për të diskutuar iniciativat e mëparshme. Qëllimi i Rrjetit është të punojë në avancimin e të drejtave të grave dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror.



Projekti "Gratë për gratë – të bashkuara në pushtet", i zbatuar nga Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC), është mbështetur nga Reactor – Research in Action dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE". Ky aktivitet financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim.

M4Y KAMPANJA PËRFSHIRËSE



Gjatë këtij muaji, ACDC vazhdoi me një fushatë informuese dhe mobilizuese me të rinjtë nga Zveçani, Skenderaj, Ranillugu dhe Vushtrria. Objektivi i fushatës është që t'u ofrojë përfituesve të synuar (grupet e të rinjve) informata rreth mundësive që ofron ky projekt dhe të inkurajojë pjesëmarrjen.

Gjithashtu, monitorimi i projekteve që po kryhen nga fituesit e granteve në ciklin e parë të M4Y ka vazhduar për të siguruar që projektet e zbatuara të përfitojnë qytetarët e synuar.



VIZITA E PËRFAQËSUESËVE TË NED

Në shtator, përfaqësuesit e National Endowment for Democracy – NED, Kaltrina Selimi, Christian Bardales dhe Aleksej Demjanski vizituan OJQ ACDC. Qëllimi i vizitës ishte bashkëpunimi i mëtutjeshëm si dhe koordinimi i aktiviteteve në kuadër të projektit "Promovimi i dialogut ndëretnik në vetëqeverisjen lokale".

Projekti i financuar nga National Endowment for Democracy synon të promovojë angazhimin ndëretnik në pushtetin lokal në veri të Kosovës. Iniciativat e projekteve lokale që adresojnë nevojat e komuniteteve lokale janë zhvilluar dhe përgatitur në bashkëpunim me Komitetet e Komuniteteve dhe banorët në Mitrovicën e Veriut dhe do të fillojnë në muajt në vijim.



Një grup OJQ-sh, përfshirë ACDC-në, deklaroi për media në lidhje me vendimin kundër studentit nga Beogradi, Nikola Nedeljković, për gjoja kriminele dhe "provokimit të urrejtjes dhe intolerancës etnike".

Si organizatë që merret me sundimin e ligjit, kemi shprehëm një shqetësim të madh për zbatimin e pabarabartë të ligjit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme në Kosovë.

Lexoni deklaratën e plotë në serbisht, shqip dhe anglisht.

[SRB](#)

[ALB](#)

[ENG](#)